

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ZEN+ PROJECT & PARTNERS” SHPK

Sot më datën 06.06.2022 (gjashtë qershor, dymijë e njëzetëedy), në Sarandë, unë **Zenel Bajrami**, atësia Fatmir, amësia Almira, shtetas shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në adresën Rr. Lefter Talo; Nd. 102; H.5; Sarandë; i datëlindjes 03.11.1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 032641238 dhe nr. personal I91103083C, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë deklaroj se kam hartuar dhe nënshkruar aktin e themelimit dhe statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, Sh.p.k., (më poshtë referuar si Shoqëria); bazuar në legjislacionin në fuqi, e veçanërisht në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; dhe nenin 22 (si dhe neneve në vijim) të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Sikurse kërkuar në legjislacionin në fuqi ky dokument përmban të dhënat e nevojshme dhe mënyrën e funksionimit të kësaj Shoqërie, si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “Zen+ Project & Partners” Shpk

NENI 2

Forma ligjore dhe selia

- 2.1 Shoqëria gëzon statusin e personit juridik shqiptar dhe si e tillë në respektim të neneve 24 deri 38 të Kodit Civil, si dhe të Ligjit nr.9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, të Ligjit nr.9916, datë 12.05.2008, i ndryshuar, të ligjit Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015, fiton personalitet juridik nëpërmjet këtij dokumenti, e për pasojë do të fillojë aktivitetin e saj tregtar pas regjistrimit në QKB, si dhe ne organet tatimore, në zbatim të neneve 20/1,26,28,32,35 të po këtij ligji.
- 2.2 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën kryesore: Rr. “Lefter Talo”, Nd.102, Nj.A. Sarandë, 9701, Bashkia Sarandë, Vlorë.
- 2.3 Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë në një adresë tjetër. Ortakët ose personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

Objekti

- 3.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj si zyrë/studio konsulence për studime, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim duke ofruar shërbimet e veta nëpërmjet konsulencave profesionale në fushat e spjeguar, si më poshtë vijon:
- a- Shërbim konsulence, studime urbane, shërbime në planifikim urban, transport dhe lëvizshmëri të qëndrueshme, infrastrukturë ambientale dhe pejsazh;

- b- Studime fizibiliteti, mundshmëri dhe analiza financiare, studime tregu;
- c- Projektim, restaurim dhe zbatim të objekteve civile, arsimore, sportive, industriale, bujqësore, projektim e zbatim interieri;
- d- Studim e projektim në fushat si inxhinieri ndërtimi/konstruksion, inxhinieri elektrike, inxhinieri hidro-mekanike dhe hidrogjeologjike e gjeologjike, fotogrametri, hartografi dhe topografi;
- e- Manaxhim dhe përpunimi i të dhënave nëpërmjet sistemeve GIS;
- f- Projektme dhe zbatime linjash dhe sistemesh së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektim ujësjellës, kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditëse, diga, etj;
- g- Projektme dhe zbatime rrugësh, urash, porte turistike;
- h- Shërbime konsulence për trajnime dhe ngritje kapacitetesh të enteve publike dhe private;
- i- Ofrimi i shërbimeve të konsulencës në fushën e menaxhimit, marketimit dhe vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- j- Blerje dhe shitje, dhënie dhe marrja me qira trojesh, ndërtesa dhe pasuri të paluajtshme;
- k- Tregëtim mallrash brenda dhe jashtë vendit.

3.2 Për të realizuar objektin dhe qëllimin e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga ligji vetëm ose në bashkëpunim me palë të treta nëpërmjet bashkimit të operatorëve (*joint venture*) dhe/ose nënkontraktimit, qoftë ky aktivitet tregtar, juridik, financiar, promocial, etj. që e vlerëson të dobishme.

NENI 5 Kohëzgjatja dhe vula

- 4.1 Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 4.2 Shoqëria do të ketë vulën e saj, përmbajtja e së cilës do të jetë e qart me elementet e emrit sipas nenit 1 në këtë dokument, adresën e selisë dhe numrin tregtar me të cilin shoqëria do të pajiset në vijim sipas ligjit

NENI 5 Kapitali i shoqërisë dhe kuotat

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 10,000 Lek, i përbërë nga 1 (një) kuotë e vetme. Ky kapital mund të shtohet ose të pakësohet prej ortakut të shoqërisë (apo ortakëve nëse në të ardhmen do të ketë) sipas ligjit dhe dokumenteve themeltare të kësaj Shoqërie dhe për këtë do të nevojitet vendimi i Asamblesë së Përgjithshme, sipas kushteve të realizimit të qëllimit të fitimit.
- 5.2 Kapitali themeltar zotërohet tërësisht nga ortaku themelues, dhe sipas ligjit pranohet e nënshkruar prej këtij të fundit si vijon:
Zenel Fatmir Bajrami zotëron 1 kuotë me vlerë totale 10.000 (dhjetëmijë) lekë ose 100% të kapitalit themeltar (pjesëmarrja në përqindje).
- 5.3 Derdhja e kapitalit do të kryhet për llogari të shoqërisë pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar.
- 5.4 Për përmbushjen e objektit të vepritarisë së saj, Shoqëria mund të hap dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo në valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo me kapital të huaj, të nivelit të dytë, duke pasur kështu të drejtën e disponimit lirisht të mjeteve monetare të akumuluar në to duke respektuar në çdo rast legjislacionin në fuqi.
- 5.4 Kuoatat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a- kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b- shitblerjes;
- c- trashëgimisë;
- d- dhurimit;
- e- çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

- 5.5 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të pronësisë mbi kuotën, kushtet e tjera të kalimit përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata e cila do të jetë në formë shkresore. Për çdo gjë tjetër lidhur me sa më lart do të zbatohen përcaktimet e nenit 10 të ligjit nr.129/ 2014 date 02.10.2014 “Për disa ndryshime në Ligjin 9901, date 14.04.08 “P2r tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 5.6 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 6

Transferimi i kuotave të kapitalit tek të tretet

- 6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, dhurim, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 6.2 Në rast të shtimit të ortakëve në të ardhmen, dhe transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t’i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën të palvlefshëm transferimin e kuotave.
- 6.3 Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- 6.4 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

NENI 7

Ortakët

- 7.1 Shoqëria ka të drejtë që të ushtrojë aktivitetin e saj me Ortakun themelues si edhe duke pranuar ortakë të tjerë sipas këtij dokumenti dhe akteve ligjore në fuqi.
- 7.2 Ortaku i vetëm themelues i saj është:
Zenel Bajrami, atësia Fatmir, amësia Almira, shtetas shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në adresën Rr. Lefter Talo; Nd. 102; H.5; Sarandë; i datëlindjes 03.11.1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 032641238 dhe nr. personal I91103083C.

NENI 8

Organet e shoqërisë

- 8.1 Organet vendimarrëse dhe administrative të Shoqërisë janë (i) Asambleja e Përgjithshme (referuar edhe si Asambleja e Ortakëve) dhe (ii) Administratori/ët.
- 8.2 Të gjitha vendimet e marra prej Asamblese së Përgjithshme duhet të regjistrohen në një regjistër të posaçëm të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Vendimet e paregjistruara në regjistër janë absolutisht të palvlefshme.

- 8.3 Deri sa të caktohet ndryshe në të ardhmen, në Shoqëri të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, sipas nenit 81/3 të Ligjit 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ushtrohen nga ortaku i vetëm themelues sipas nenit 7 të këtij dokumenti.

NENI 9

Asambleja e përgjithshme

- 9.1 Përtej parashikimeve ligjore në fuqi, roli i Asamblesë së Përgjithshme do të jetë kryesisht, por pa u kufizuar vetëm në to:
- a- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b- ndryshimet e statutit;
 - c- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e- përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
 - f- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 9.3 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 10

Thirrja e mbledhjes dhe marrja e vendimeve

- 10.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.2 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 % (pesëdhjetë për qind) të kuotave.
- 10.3 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.4 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

- 10.5 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- 10.6 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :
- a- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d- përcaktimin e shpërblimeve
 - e- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - f- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - g- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- 10.7 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 11

Administrimi i shoqërisë

- 11.1 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 11.2 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
- 11.3 Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 11.3 Për sa më sipër përcaktuar, Administrator i shoqërisë emërohet, me një afat 5-vjeçar:
Zenel Bajrami, atësia Fatmir, amësia Almira, shtetas shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në adresën Rr. Lefter Talo; Nd. 102; H.5; Sarandë; i datëlindjes 03.11.1989, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr. 032641238 dhe nr. personal I91103083C.

NENI 12

Kompetencat e Administratorit/ëve

- 12.1 Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:
- a- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

- g- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 12.2 Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
- a- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
 - c- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- 12.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë
- 12.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 13 **Përgjegjësitë e Administratorit**

- 13.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- 13.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- 13.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:
- a- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d- të parandalojë dhe mënjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e- të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 13.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 13.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

- 13.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a- u kthen ortakëve kontributet;
 - b- u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c- u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d- lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e- jep kredi.
- 13.7 Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.
- 13.8 Padiësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

NENI 14

Viti Financiar dhe eksperti kontabël

- 14.1 Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 14.2 Eksperti kontabël ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 14.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

NENI 15

Prishja dhe likuidimi

- 15.1 Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë:
- a- kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b- me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
 - c- me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin.
 - e- me vendim të gjykatës.
- 15.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 15.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

- 15.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 17
Mosmarrëveshjet

- 17.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

NENI 18
Baza Ligjore

- 18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 18.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU/ËT E SHOQËRISË
"ZEN+ PROJECT & PARTNERS" SHPK

Zenel BAJRAMI
